



SUPPORTING EMPLOYMENT OF YOUNG PEOPLE



This project is funded by the European Union

Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë (APRM), në suaza të projektit “Mbështetja për punësimin e të rinjve”, të financuar nga ana e Programit Operativ për “Zhvillimin e burimeve njerëzore 2007-2013” Komponenti IPA IV), por në bazë të Planit Operativ të shërbimeve në tregun e punës dhe programeve e masave aktive të punësimit për vitin 2017, bën:

Shpallje publike

të rinjtë e papunë që të dorëzojnë aplikacion për pjesëmarrje në “Stërvitjen për aftësitë e kërkuara në tregun e punës”

U bëhet thirrje personave që janë të regjistruar si të papunë (kërkues aktiv të punës) të moshës deri 29 vjet, që të shprehin interesim dhe të apalikojnë në njërin nga profesionet fundamentale të theksuara në listë dhe të marrin pjesë në stërvitjet për të fituar njohuri plotësuese dhe aftësi profesionale të cilat janë të kërkuara në tregun e punës.

Këto stërvitje gjatë vitit 2017 do ta rrisin punësimin e 220 personave të papunë deri në moshën 29 vjet dhe do të sigurojnë mundësi për rritjen e shkathtësive profesionale dhe marrjen e kualifikimeve për profesionet specifike të kërkuara në tregun e punës.

Të gjithë të papunët deri në moshën 29 vjet që janë të interesuar dhe të evidentuar në Agjencinë e Punësimit si kërkues aktiv të punës, mund të paraqiten për pjesëmarrje në ndonjërin nga profesionet siç vijojnë në listë:

- Nëpunës kontabiliteti (100 kandidatë);
- Përkujdesës për persona të moshuar dhe të pafuqishëm në kushte shtëpiake (për 40 kandidatë);
- Masazhbërës (për 40 kandidatë);
- Kozmetist (për 40 kandidatë);

Stërvitjet do të mbahen në një periudhë prej katër muajsh. Stërvitjet përfshijnë ligjërata, orë përgatitore për provim dhe provimet për marrjen e certifikatës.

Çdo person i papunë që zgjidhet për të marrë pjesë në stërvitje do të nënshkruajë marrëveshje për pjesëmarrje në stërvitjen për të cilën ka aplikuar.

Harxhimet mujore për pjesëmarrësit në stërvitje në shumën prej 6.261,00 denarë, duke përfshirë sigurimin në rast fatkeqësie gjatë punës dhe tatimin personal për të ardhurat për secilin pjesëmarrës, do të mbulohen nga ana e Agjencisë së Punësimit.

Pas mbarimit të stërvitjes, secili nga pjesëmarrësit që e plotëson kushtin e më së paku 70 për qind të pjesëmarrjes në orët e parapara dhe që ka marrë vërtetimin për realizimin e stërvitjes praktike, do të mund të japë provimin për verifikimin dhe vlerësimin e njohurive dhe aftësive të fituara para komisionit. Gjithashtu ekziston mundësia që disa trajnime të mos realizohen në ato qytete ku nuk do të mund të zgjedhet trajner i përshtatshëm.

Kriteret e aplikimit:

Të papunët afatgjatë të moshës deri 29 vjet që janë të interesuar e të evidentuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë, do të paraseleksionohen nga baza e kërkuesve aktiv të punës që janë të regjistruar në përputhje me deklaratën e tyre në planin individual për punësimin (IP). Kandidatët e paraseleksionuar do të thirren që të plotësojnë aplikimin për pjesëmarrje në Agjencinë e Punësimit ose në ndonjërin nga qendrat e punësimit dhe të zgjedhin stërvitjen për të cilën janë të interesuar më së shumti.



This project is implemented by



Employment Service Agency



SUPPORTING EMPLOYMENT OF YOUNG PEOPLE



This project is funded by the European Union

Secili kandidat, për të mundur të marrë pjesë në stërvitje, duhet t'i plotësojë kriteret siç vijojnë:

- Të jenë të regjistruar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë si kërkues aktiv të punës;
- Deklaratë në planin individual të punësimit (PIP), nëse e ka plotësuar;
- Aplikimin e pjesëmarrjes të plotësuar në APRM ose në cilëndo qendër tjetër të punësimit brenda shtetit;
- Arsimimin adekuat, aty ku është relevante, varësisht nga lloji i stërvitjes që e ka zgjedhur.

Përzgjedhja përfundimtare e pjesëmarrësve do të bëhet nga ana e komisionit të evaluimit në bazë të kritereve të lartpërmendura, duke formuar listën e rangimit të kandidatëve të interesuar për të marrë pjesë në stërvitjet për shkathtësitë e kërkuara në tregun e punës të cilat planifikohen të organizohen në periudhën e ardhshme.

Nëse numri i pjesëmarrësve të interesuar e kalon numrin e planifikuar të kandidatëve për stërvitjet e caktuara, atëherë do të zbatohen kritere plotësuese për përzgjedhje të cilat bashkangjitur me numrin e viteve të regjistrimit të personit si i papunë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë, do t'i përfshijnë edhe parimet siç vijojnë, si kritere plotësuese në përzgjedhje:

- Kandidatët të cilët tanimë kanë marrë pjesë në ndonjë stërvitje të caktuar për shkathtësitë e kërkuara në tregun e punës, nuk mund të përfshihen sërish në stërvitje;
- Nëse kandidatët kanë arsimim të ngjashëm për atë që mbahet stërvitja, atëherë do të merret parasysh si përparësi gjatë përzgjedhjes;
- Nëse numri i kandidatëve të përshtatshëm është më i madh sesa ai i planifikuari për pjesëmarrje në stërvitje, atëherë kandidatët do të zgjidhen sipas kualifikimit në listën e rangimit të kandidatëve.

Kandidatët të cilët deri tani nuk kanë marrë pjesë në stërvitje të këtilla inkurajohen që të paraqiten për të marrë pjesë. Agjencia e Punësimit i inkurajon të gjithë të papunët deri në moshën 29 vjet të gjinive, përkatësive kombëtare dhe kulturore të ndryshme, të apikojnë me qëllim që të marrin aftësi relevante për shkathtësitë specifike profesionale që kërkohen në tregun e punës. Personat e grupeve të pakicave, si dhe personat me nevoja të posaçme inkurajohen që të marrin pjesë.

Agjencia e Punësimit e ruan të drejtën për t'i refuzuar kandidatët që nuk i plotësojnë kriteret e nevojshme

Procedura dhe afati i aplikimit

Personat e papunë deri në moshën 29 vjet që janë të interesuar dhe të regjistruar si kërkues aktiv të punës, mund të dorëzojnë aplikacion poër pjesëmarrje në Agjencinë e Punësimit dhe në ndonjërin nga 30 qendrat e punësimit brenda shtetit, duke e shprehur interesimin e tyre ndaj stërvitjeve për aftësitë e kërkuara në tregun e punës, duke theksuar llojin e stërvitjes, çdo ditë prej orës 8:30 deri 16:30, çdo ditë pune duke filluar prej 07.02.2017.

Shpallja publike do të jetë e hapur deri në plotësimin e numrit të planifikuar të personave për stërvitje në këtë masë aktive.

Të gjitha të dhënat e përfshira në fletëparaqitjen e pjesëmarrjes do të trajtohen në mënyrë sekrete.



This project is implemented by



Employment Service Agency



SUPPORTING EMPLOYMENT OF YOUNG PEOPLE



This project is funded by the European Union

Informata të hollësishme mund të merren në klubet e 30 qendrave të punësimit ku pesonat janë të evidentuar si të papunë, si dhe në telefonin kontaktues (02) 3213 070 dhe ueb faqen e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë www.avrm.gov.mk.

Shpallja publike do të botohet në ueb faqet siç vijojnë:

- Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë www.avrm.gov.mk
- Ministria e Punës dhe Politikës Sociale www.mtsp.gov.mk

